Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/473
Datë: 04.08.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 03.08.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** Mindbulb Education, rr. Ernest Koliqi, nr.18, Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 03.08.2023 deri 02.08.2026, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

    1.1 Kurse të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri C1, Mindbulb Education për këtë profil mund të realizojë procesin e aftësimit për një vit kalendarik në total 20 grupe në vit, ndërsa numri i kandidatëve për grup duhet të jetë 16 kandidatë.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Mindbulb Education, për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Në total shkolla mund të ofrojë kurse për 320 nxënës në vit. Janë të angazhuar 2 mësimdhënës me orar të plotë x 8 grupe x 16 nxënës për grup = 256, si dhe 1 mësimdhënës me orar gjysmë të plotë x 4 grupe x 16 nxënës për grup = 64.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Mindbulb Education;
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar KD së AKK